REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 35 Akti

# VENDIM

## "PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK"

Ne Tirane, sot me date 7.6. 1994, une Arila Cafo, gjyqtare e Gjykates se rrethit, mbasi shqyrtova materialet e paraqitura nga themeluesit e fondacionit Eleonora Bregu dhe Drini Ajdinlli per tu njohur e regjistruar si person juridik,

## KONSTATOVA

Themeluesit e Fondacionit "Vakefi i shenjte i lidhjes hyjnore", Z.Z.Eleonora Bregu e Drini Ajdinlli kane paraqitur ne gjykate kerkesen e tyre per tu regjistruar si person juridik per realizimin e qellimeve shoqerore me karakter humanitar e spiritual per te sheruar, kuruar semundje te ndryshme fizike e psihike tek njerezit besimtare me ndihmen e te Madhit Zot, per lumturi familjare dhe permiresimin e gjendjes ekonomike.

Te frymezuar dhe te udhehequr nga keto parime te shenjta hyjnore, Kryetarja e Fondacionit Z.Eleonora Bregu dhe zv.kryetari i tij Drini Ajdinlli u sherbejne falas njerezve besimtare me kete veprimtari bamirese spirituale per rikthimin e tyre ne jete. Titullohen Nigjar e Erenler.

Nga shqyrtimi i dokumenteve, rezulton se kjo veprimtari eshte e rregullt, prandaj edhe kerkesa e tyre bazohet ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

## PER KETO ARESYE:

Ne baze te Ligjit Nr.7695, date 7.4.1993 Per fondacionet

## VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te fondacionit: "Vakefi i shenjt i lidhjes hyjnore" themeluar nga Z.Z.Eleonora Bregu e Drini Ajdinlli per realizimin e qellimeve humanitare e spirituale per sherimin e kurimin e semundjeve fizike e psihike tek njerezit besimtare, pa shperblim, per lumturine e tyre familjare dhe permiresimin e gjendjes ekonomike.

Kunder ketij vendimi, lejohet ankim ne shkalle te dyte.

Tirane, me ________ 1994

GJYQTARE
Arila Cafo